



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .04.2024

**MBLEDHJA Nr. 10,  
Datë 12.04.2024, ora 10:00  
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 12.04.2024, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 10 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të ERE-s më datë 19.02.2024 dhe datë 22.02.2024.
2. Mbi licencimin e shoqërisë “Protergia Energy Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “FU-GEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Bashkinë Fier.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 10 MW me vendndodhje në Bashkinë Lushnje, Qarku Fier.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
6. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.05.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Blue 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW”, i ndryshuar.
7. Mbi heqjen e pezullimit të vendosur me vendimin nr. 309, datë 30.10.2023, “Mbi pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “EnSCO Trading (Albania)” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

9. Mbi dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga Hec “Bistrica 1” dhe “Bistrica 2”, të shoqërisë “Kurum International” sh.a., për vitin 2023.
10. Mbi dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga Hec “Shkopet”, i shoqërisë “Kurum International” sh.a., për vitin 2023.
11. Mbi dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga Hec “Ulëz”, i shoqërisë “Kurum International” sh.a., për vitin 2023.
12. Mbi kërkesën e shoqërisë “Wenerg” sh.a. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e barrës siguroese të radhës së dytë mbi aksionet e saj, për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARE NË DETYRË**  
**Erjola SADUSHI**